

Ka një tregim Gabriel Garcia Marquez, *Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë*, ku shpresa përshkruhet në mënyrë të përkryer në një shkëmbim të shkurtër. E shoqja i thotë kolonelit: ‘Shpresën nuk e han dot’ dhe koloneli i përgjigjet, “Për ta ngënë nuk e ha dot, por shpresa të mban”.

Ky reflektim i thjeshtë por i thellë mbi shpresën, rezonon fort me gjetjet e Barometrit të Ballkanit. Pavarësisht sfidave të shumta të prekshme të rajonit, është shpresa ajo që vazhdon të mbajë dhe të motivojë popujt e tij. Sot, ndërsa zhytmi në dhjetë vite të dhënash, do të eksplorojmë jo vetëm vështirësitë, por edhe qëndresën që e karakterizon Ballkanin Perëndimor.

Por para se të filloj të thellohem në gjetjet, më lejoni të them disa fjalë për atë çfarë e bën Barometrin e Ballkanit unik.

-Fokusi i tij është specifikisht në Ballkanin Perëndimor, duke shënjestruar rajonin tonë dhe ofruar kështu një analizë të hollësishme, çka shpesh anashkalohet nga anketat më të gjera evropiane ose globale.

-Ofron një perspektivë të dyfishtë duke mbledhur të dhëna si nga qytetarët ashtu edhe nga bizneset, me një panoramë gjithëpërfshirëse të ndjeshmërisë publike, krahas besimit të biznesit dhe tendencave të tregut.

-Është i përvitshëm, kështu që gjurmon ndryshimet në kohë, duke mundësuar identifikimin e tendencave dhe ndryshimeve.

Thënë kjo, pas një dekade të kapjes së pulsit të Ballkanit Perëndimor, ne jemi të ngazëllyer që po ndajmë tendencat e fundit dhe informacione të freskëta nga edicioni 2024 i Barometrit të Ballkanit. Sot, ne duam QË JU të bëheni pjesë e këtij bashkëbisedimi. Më lejoni t’ju jap një shije të të dhënave që kemi mbledhur.

Cili mendoni se është shqetësimi më i madh i njerëzve në Ballkanin Perëndimor sot?

Ja një sugjerim: në dhjetë (10) vitet e fundit, kjo temë shpërfaqet si shqetësimi kryesor, duke lënë pas papunësinë dhe ekonominë. Nëse menduat për rritjen e çmimeve dhe inflacionin, kenë dhënë përgjigjen e saktë. Nuk është befasi, marrë parasysh se inflacioni në Ballkan është tetë pikë një përqind (8.1), pothuajse dyfishi i inflacionit në BE që është tre pikë katër përqind (3.4), ndërsa çmimet e ushqimeve janë thuajse të njëjta si në BE. Megjithatë, PBB-ja jonë është vetëm gjysma e asaj të BE-së.

Është interesante se, për herë të parë pas shumë kohësh, papunësia nuk është më një ndër tre shqetësimet kryesore për të rinjtë. Vëmendja e tyre është përqendruar në korrupsionin dhe rritjen e kostos së jetesës. Ndërkohë, bizneset mbeten të pasigurt lidhur me të ardhmen ekonomike të rajonit. Një e treta e bizneseve beson se gjendja do të përmirësohet, ndërsa një e pesta druan se do të përkeqësohet. Edhe pse ky shënon një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin e kaluar, optimizmi mbetet nën nivelet para pandemisë.

Gjërat po ndryshojnë – jo vetëm rrethanat rreth nesh, por edhe mënyra se si e shohim botën.

Mbështetja për anëtarësimin në BE, që filloi me 39% në 2015, arriti kulmin me 62% në 2021, dhe që nga ai moment ka nisur rënia. Sot, mbështetja për BE-në qëndron në nivelin e pesëdhjetë e katër përqindëshit (54%), kuota më e ulët në gjashtë (6) vite. Shqipëria dhe Kosova kryesojnë grupin mbështetës, me përkatësisht shtatë dhjetë e shtatë përqind (77%) dhe shtatëdhjetë e katër përqind (74%), ndërsa Serbia dhe Mali i Zi i prijnë mosbesimit, me përkatësisht tridhjetë e katër përqind (34%) dhe tridhjetë e nëntë përqind (39%).

Kjo lodhje nga të duruarit ndihet gjithashtu, megjithëse në një masë më të vogël, edhe në qarqet e biznesit. Ndërsa mbështetja për anëtarësimin në BE midis bizneseve ka rënë me shtatë përqind (7%) këtë vit, ajo ende mbetet më e lartë sesa tek publiku i gjerë, me (64%) të bizneseve në favor të anëtarësimit.

Pavarësisht këtyre sfidave, shpresa vazhdon. Dyzet e tre përqind (43%) e qytetarëve besojnë se anëtarësimi në BE do të ndodhë deri në vitin (2035), ndërsa një e treta (1/3) mendojnë se do të ndodhë pas vitit 2040 ose kurrë.

Në aspektin pozitiv, besimi te bashkëpunimi rajonal po rritet. Një rekord prej tetëdhjetë e dy përqind (82%) e qytetarëve shprehën këtë vit mbështetjen për bashkëpunimin rajonal, më i larti që nga fillimi i Barometrit të Ballkanit në vitin 2015. **Kjo tregon se bashkëpunimi rajonal ka një vlerë të vetën, dhe nuk trajtohet si dikur, në kontekstin e integritetit evropian.** Pesëdhjetë e nëntë përqind (59%) e tyre presin përfitime nga mundësia e udhëtimit me karta identiteti dhe përdorimi i shërbimit falas të roaming-ut teksa udhëtojnë në rajon.

Megjithatë, nacionalizmi si besim i fuqishëm po përjeton shumë transformime dhe mbetet një pengesë e madhe për bashkëpunim më të thellë. Kur u pyetën se "çfarë pengon bashkëpunimin rajonal", dyzet e shtatë përqind (47%) u përgjigjen se arsyeja është politikën nacionaliste, pasuar nga tridhjetë e shtatë përqind (37%) që theksuan mungesën e besimit për shkak të historisë.

10 vjet më parë, ndjenja mbizotëruese mes qytetarëve në rajon ishte "Shpresa", ndërsa sot është "Konflikti", me tendencë më të dukshme në Kosovë me tridhjetë e katër përqind (34%), Bosnje dhe Hercegovinë me njëzetë e gjashtë përqind (26%) dhe Serbi me njëzetë e pesë përqind (25%). Dialogu i papërmbytur midis Prishtinës dhe Beogradit, kërcënimet për shkëputje në Bosnje dhe Hercegovinë, problemet me të cilat u përball Maqedonia e Veriut me Greqinë dhe Bullgarinë, tensioni social, zhgënjimi, ritmi i ngadaltë i modernizimit të infrastrukturës rajonale, pengesat për treg të përbashkët dhe largimi i popullsisë, janë shkaqet kryesore pas këtij ndryshimi.

Megjithatë, ka një konstante gjatë kësaj dekade. Konstantja e pandryshueshme gjatë 10 (dhjetë) viteve të Barometrit të Ballkanit është mosbesimi ndaj partive politike me shtatëdhjetë e katër përqind (74%). Sigurisht, mosbesimi politik është bërë normë në shumë demokraci të konsoliduara por, për legjitimitetin demokratik, në rajon është mjaft e rëndësishme të kuptohen arsyet e mosbesimit ndaj politikës.

Ndërkohë, besimi tek gjyqësori dhe policia po përmirësohet në të gjithë rajonin. Ka një rritje prej dhjetë përqind (10%) gjatë pesë (5) viteve të fundit, ndoshta si rezultat i reformave në gjyqësor dhe përpjekjeve kundër korrupsionit.

Fanatizmi politik po nxit mosbesimin ndaj medias, pasi gjashtëdhjetë e katër për qind (64%) e njerëzve besojnë se media u shërben interesave politike. Gjashtëdhjetë përqind (60%) thonë se mediat sociale nuk janë burim i besueshëm informacioni, pothuajse e njëjta përqindje besojnë se lajmet e shpejta dhe të rreme janë në rritje.

Sikurse mund ta shihni dhe vetë, gjatë dhjetë viteve të fundit, janë të shumtë njerëzit që i kanë shkruar "kolonelit" të tyre. **Tani është koha që kolonelët të lexojnë letrën.**